

DAMIAN GJIKNURI



Datëlindja: 25.05.1972

Vendlindja: Tiranë

Email: Damian.Gjikhuri@parlament.al

Z. Damian Gjikhuri është diplomuar në Drejtësi në vitin 1994, në Universitetin e Tiranës dhe zotëron gradën Master në Politikat Publike dhe Ligj të lëshuar nga “Naval Postgraduate School” të Monterey, Kaliforni, SHBA (2004) dhe Kolegji i Ligjit Londër, Britani e Madhe (1996).

Ai ka kryer edhe disa studime pasuniversitare në Qendrën për Politikat e Sigurisë në Gjenevë (2000) dhe të Drejtë Ndërkombëtare në Universitetin e Leidenit, Holandë (1994).

Ai ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë për dy legjislatura, VII dhe VIII (2009-2013), (2013-2017) dhe është mandatar si deputet për herë të tretë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

Gjikhuri është anëtar i Partisë Socialiste që nga viti 2005. Ai është anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste dhe Sekretar për Çështjet Zgjedhore që nga viti 2011. Më parë, në vitin 2007, ai u zgjodh nënsekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore dhe bashkëautor i Kodit Zgjedhor 2008.

Ai ka qenë anëtar i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë (2009–2013), si dhe bashkëkryetar i Komisionit të Reformës Zgjedhore 2011–2012.

Përpara zgjedhjes si deputet, në vitin 2009, Damian Gjknuri ka punuar si drejtues i një zyre ligjore dhe këshilltar ligjor për reformat rregullatore ekonomike në vend dhe rajon, financiar nga BE, USAID, GTZ, etj.

Deri në vitin 2005 Z. Gjknuri ka ushtruar funksione të ndryshme publike, si: Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Rendit Publik (2005), Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes (2001–2005), Drejtor i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Rendit Publik dhe Koordinator Kombëtar për Çështjet e Drejtësisë dhe ato të Brendshme për negociimin e hapjes së negociatave me KE (1999 – 2001), Drejtues i Planizim–Drejtimit në SHISH (1998), Gjyqtar i Shkallës së Parë (1995-1996), jurist në institucione të ndryshme (1994-1995).

Z.Damian Gjknuri ka drejtuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë viteve 2017-2019 dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në vitet 2013-2017.